



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**URDHËR I BRËNDSHËM**

Nr 66, Datë 23.09 2015

**MBI**

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË INSTITUCIONIT TË  
AVOKATIT TË POPULLIT**

Nisur nga rëndësia që ka përgatitja dhe zbatimi i një programi institucional të transparencës nga institucioni i Avokatit të Popullit, në të cilin të përcaktohen kategoritë e informacionit që duhet të bëhen publike pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni për publikun;

duke mbajtur parasysh interesin më të mirë të publikut në garantimin dhe vënien në dispozicion, të këtij informacioni, me qëllim pakësimin e nevojës për kërkesa individuale për informacion;

**KONSTATOJ:**

Se në bazë të neneve 4 - 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin për hartimin dhe zbatimin e Programit të Transparencës dhe vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të institucionit, të një kategori të gjerë informacioni.

**PËR KËTË ARSYE**

Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, neneve 4-7 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", si dhe mbështetur në propozimin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,



## URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës për Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së institucionit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", sipas Aneksit bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Ky program të vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Institucioni i Avokatit të Popullit ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nëpërmjet vënies në dispozicion të publikut, pa kërkesë, të informacioneve, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesa individuale për informacion.
3. Programi i Transparencës mban parasysh interesin më të mirë të publikut në garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik, vënien në dispozicion, pa kërkesë, të informacioneve, si dhe modelin e miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të ligjit nr.119/2014.
4. Institucioni i Avokatit të Popullit do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare të institucionit si dhe në mjediset e pritjes së publikut.
5. Kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, përgatiten në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, duke respektuar kriteret dhe standartet e përcaktuara në nenit 7 të ligjit nr.119/2014.
6. Institucioni i Avokatit të Popullit krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.
7. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të postimit të faqes zyrtare të internetit, brenda 48 orëve nga miratimi i aktit.
8. Drejtoria e Shërbimeve ndaj Qytetarit krijon, mban dhe bën publik një rregjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.
9. Ky rregjistër përditësohet cdo 3 muaj dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në rregjistër.



10. Për ndjekjen e zbatimit të këtij Urdhëri, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Komisionerët sipas Seksioneve, Drejtoria e Shërbimeve ndaj Qytetarit si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

IGLI TOTOZANI



URDHRER I BRENDOSHEM

Nr. 50, Datë 21.05.2015

MBI

MBYLLJEN E PROGRAMIT TE TRANSPARENCESITE INSTITUCIONIT TE  
AVOKATIT TE POPULLIT

Nisur nga detyra që ka përgatitja dhe zbatimi i një programi institucional të transparencës nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në të cilin të përcaktohen kategoritë e informacionit që duhet të bëhen publike pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publike të kësaj informacioni për publikun.

duke e bërë më të lehtë interesin më të mirë të publikut në garantimin dhe vënien në dispozicion të kësaj informacioni me qëllim përcaktimin e nevojës për kërkesa individuale për informacion.

KONSTATOJ:

Se në bazë të nenëve 4 - 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Institucioni i Avokatit të Popullit ka detyrimin për hartimin dhe zbatimin e Programit të Transparencës dhe vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të Institucionit të një kategori të gjërë informacioni.

PËR KETË ARSYË

Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr.9404, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nën bazë të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe mbështetja që ofrohet nga Sekretari i Përgjithshëm.